



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE**

**LËNDA:**

**HISTORI E THELLUAR**  
**(Provim me zgjedhje)**

**Koordinatore: Ines Todhe**

**Viti shkollor 2014 – 2015**

**TIRANË, JANAR, 2015**

## **UDHËZIME TË PËRGJITHSHME**

Programi orientues i Maturës Shtetërore për lëndën me zgjedhje “Histori e thelluar” ka për qëllim përgatitjen e nxënësve për provimin e kësaj lënde. Programi përfshin konceptet më të rëndësishme nga historia- bërthamë, klasat 10,11,12 dhe nga historia e thelluar, klasat 11, 12 mbi njohuritë, aftësitë e qëndrimet themelore që i duhen nxënësit të zotërojë në lëndën e historisë.

Ky program është hartuar duke u bazuar në programet e historisë së gjimnazit të kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje.

Programi orientues i Maturës Shtetërore për provimin me zgjedhje të lëndës së historisë së thelluar, bazuar në udhëzimin Nr. 1, datë 12.01.2015 të MAS-it për “Zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore 2015”, përbën një dokument të vlefshëm për mësuesit e gjimnazit, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit dhe vlerësimit të testit të Maturës Shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e historisë së gjimnazit, që do të përgatisin maturantët për provimin e historisë së thelluar, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore 2014-2015.
- Programi orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e historisë së thelluar, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së thelluar, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesit. Kujdes i veçantë të bëhet nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të historisë së thelluar, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore, të cilët nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimorë që nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përbajnjë vetëm ato koncepte, njohuri dhe aftësi të trajtuara në këtë program.

Mësuesit që do të përgatisin nxënësit për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën e historisë së thelluar të mbështeten në objektivat e këtij programi orientues (objektivat e historisë

bërthamë dhe objektivat e historisë së thelluar), në mënyrë që të aftësojnë nxënësit për të përvetësuar të gjitha njohuritë, konceptet dhe aftësitë e përcaktuara në këtë program. Për këtë qëllim, mësuesi dhe nxënësi duhet të shfrytëzojnë disa materiale burimore.

Përgatitja e nxënësve për provimin e historisë të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që nxënësit të sigurojnë përvetësimin cilësor të objektivave mësimorë, koncepteve historike dhe aftësive të përcaktuara në këtë program.

Nxënësit të kenë parasysh se fusha e cila ka numrin më të madh të orëve dhe përqindjen më të madhe në programin orientues të Maturës Shtetërore, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

#### **Programi është i organizuar sipas këtyre rubrikave:**

- Udhëzime të përgjithshme.
- Linjat e programit histori- bërthamë.
- Përshkrimi i linjave dhe objektivat e programit histori-bërthamë.
- Linjat e programit histori e thelluar.
- Përshkrimi i linjave dhe objektivat e programit histori e thelluar.
- Tabela e peshave.

#### **Literatura e sugjeruar për nxënësit në lëndën “Histori e thelluar”:**

- Tekstet e historisë bërthamë për gjimnazin, të miratuara nga MAS.
- Tekstet e historisë së thelluar për gjimnazin, të miratuara nga MAS.

#### **Literatura e sugjeruar për mësuesit dhe përhartuesit e testit për lëndën “Histori e thelluar”:**

- Tekstet e historisë bërthamë për gjimnazin, të miratuara nga MAS.
- Tekstet e historisë së thelluar për gjimnazin, të miratuara nga MAS.
- Standardet lëndore të gjimnazit për lëndën “Histori”.
- Programet lëndore të gjimnazit për lëndën “Histori bërthamë”, klasat 10,11,12.
- Programet lëndore të gjimnazit për lëndën “Histori e thelluar”, për klasat 11 dhe 12.

- Udhëzuesi për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit.

## **LINJAT E PROGRAMIT – HISTORI BËRTHAMË**

### **Fusha 1**

### **Qytetërimet në Antikitet dhe Mesjetë**

Qytetërimi në parahistori

Qytetërimi botëror në Antikitet (Egjipti, Mesopotamia, Greqia, Roma)

Qytetërimi botëror në Mesjetë (shek. V - XV).

### **Fusha 2**

### **Qytetërimet moderne dhe bashkëkohore**

Qytetërimet në fillimet e historisë moderne

Koha e ndryshimeve thelbësore

Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

Qytetërimet bashkëkohore (1945 deri më sot).

### **Fusha 3**

### **Historia e shqiptarëve**

Parahistoria 100000 vjet - 3500 vjet më parë

Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II - mijëvjeçari I para erës së re)

Shqiptarët gjatë sundimit osman (shek. XV - XX)

Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939

Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939 -1944)

Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)

Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2008.

## **PËRSHKRIMI I LINJAVE DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT**

**Përshkrimi i përmbajtjes** është vendosur në këtë rubrikë të programit për të orientuar hartuesit e testit të lëndës, mësuesit dhe nxënësit në zberthimin e objektivave të programit orientues të MSh.

## **QYTETËRIMET NË ANTIKITET DHE MESJETË**

## **Linja 1 Qytetërimi në parahistori**

Kjo linjë ka për qëllim të zbulojë dhe të argumentojë evolucionin e shoqërisë njerëzore në parahistori dhe elementet e para të kulturës dhe të besimit të kësaj shoqërie. Nëpërmjet kësaj linje, nxënës/i,-ja aftësohet në periodizimin e historisë.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
1.	<b>Qytetërimi në parahistori</b>	<b>Historia e qytetërimit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Ç'kuptojmë me qytetërim?</li><li>- Periodizimi i parahistorisë.</li><li>- Organizimi kronologjik i historisë.</li><li>- Besimi dhe artet në parahistori.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të përdorë saktë këta terma e koncepte kyçë historike: qytetërim, histori e qytetërimit, periodizim, parahistori, paleolit, mezolit, neolit, eneolit.</li><li>- Të shpjegojë kuptimin e nocionit qytetërim si tërsi e vlerave materiale e shpirtërore të krijuara përgjatë historisë.</li><li>- Të përcaktojë shtrirjen kohore të parahistorisë dhe të historisë si dhe periodizimin e tyre.</li><li>- Të përshkruajë zhvillimin e besimit dhe të artit në komunitetet e para njerëzore, si pikënisje e qytetërimit botëror.</li></ul>

## **Linja 2 Qytetërimi botëror në Antikitet (Egjipti, Mesopotamia, Greqia, Roma)**

Kjo linjë ka për qëllim të formojë te nxënës/i,-ja një kulturë të saktë dhe të plotë historike mbi qytetërimet antike të Egjiptit, Mesopotamisë, Greqisë dhe Romës; të formojë bindjen mbi zhvillimin kronologjik të tyre dhe kontributet e qytetërimit paraardhës në qytetërimin pasardhës, duke argumentuar se qytetërimi botëror sot i ka rrënjet në qytetërimin e botës antike.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
2.	<b>Qytetërimi botëror në Antikitet (Egjipti, Mesopotamia, Greqia, Roma)</b>	<p><b>Qytetërimet e hershme. (Mijëvjeçari IV – II pr. K)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shteti dhe shoqëria në Mesopotami.</li> <li>- Shteti dhe shoqëria në Egjipt.</li> </ul> <p><b>Qytetërimet në brigjet e deteve të Mesdheut</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shteti dhe ligji në Greqinë antike.</li> <li>- Shteti dhe ligji në Romën antike.</li> <li>- Shoqëria dhejeta e përditshme në qytetërimin antik grek dhe romak.</li> <li>- Arti, kultura dhe shkenca në qytetërimin antik grek e atë romak dhe përhapja e tyre.</li> <li>- Besimi në lashtësi.</li> <li>- Ndërprerja e qytetërimit antik në Europë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përdorë saktë këta terma e koncepte kyçë historike: mbeturinë lumore, pushtet hyjnor, pushtet zot, pushtet i dhuruar nga zoti, shkrim hieroglif, kuneiform, piramidë, kode, qytet-shtet (polis), koloni, luftë civile, oligarki, demokraci, tirani, patricë, plebenj, skllavopronar, gladiatorë, mbretëri, republikë, triumvirat, principatë, perandori, hark i triumfit, kolose, obelisk, krishterim, dyndje.</li> <li>- Të përcaktojë kohën e lindjes dhe të zhvillimit të qytetërimeve në Egjipt dhe në Mesopotami.</li> <li>- Të krasojë tiparet dhe veçoritë e jetës ekonomike e sociale në Egjipt dhe në Mesopotami.</li> <li>- Të identifikojë tiparet e organizimit shtetëror dhe karakteristikat e tij në Mesopotami dhe në Egjipt.</li> <li>- Të përshkruajë evolucionin politik të qytet-shteteve të Athinës dhe të Spartës.</li> <li>- Të dallojë veçoritë e jetës athinase nga ajo spartane.</li> <li>- Të vlerësojë tiparet e kulturës greke dhe helenistike.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përcaktojë kronologjisht evolucionin e shtetit në Romë (mbretëri, republikë, principatë, perandori).</li> <li>- Të analizojë krijimin e së drejtës romake si një prej legjisacioneve më të rëndësishme për jurisprudencën botërore.</li> <li>- Të shpjegojë tiparet e jetës shoqërore në qytetërimin grek dhe romak.</li> <li>- Të dallojë arritjet në kulturën, artin e shkencën në qytetërimin grek e romak.</li> <li>- Të përshkruajë ndikimin e kulturës greko-romake në Iliri.</li> <li>- Të tregojë veçoritë e besimit kristian.</li> <li>- Të përcaktojë shkaqet e ndërprerjes së qytetërimit antik dhe lindjen e një qytetërimi të ri.</li> </ul>
--	--	---

### Linja

### Qytetërimi botëror në Mesjetë (shek. V – XV)

Kjo linjë ka për qëllim të shpjegojë, të analizojë dhe të krijojë një botëkuptim të plotë mbi qytetërimin mesjetar. Linja synon të tregojë thelbin ekonomik, politik e fetar të këtij qytetërimi si dhe rolin e qyteteve në zhvillimin e elementeve të reja, të cilat paraprijnë lindjen e qytetërimit të ri modern.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
3.	<b>Qytetërimi botëror në Mesjetë. (shek. V – X)</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përdorë saktë këta terma e koncepte kyçë historike:</li> </ul>

	<p><b>Mesjetë</b> <b>(shek. V - XV)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tiparet e organizimit shtetëror e ekonomik në qytetërimin bizantin.</li> <li>- Kodi i Justinianit.</li> <li>- Tiparet e qytetërimit arab.</li> </ul> <p><b>Evolucion i qytetërimeve mesjetare. (shek. X – XV)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Feudalizmi në formën e tij klasike.</li> <li>- Lindja e qyteteve, zhvillimi i tregtisë, ndryshimet në strukturën shoqërore dhe në mënyrën e jetesës.</li> <li>- Kryqëzatat dhe pasojat e tyre.</li> <li>- Monarkia angleze.</li> <li>- Monarkia franceze.</li> </ul>	<p>mesjetë, perandori bizantine, islam, islamizëm, kuran, ndarje e kishës, vend i shenjtë, kryqëzatë, feudalizëm, feud, fisnik, vasal, vasalitet, bujkrob, detyrime, çiflig, qytet, karta e madhe e lirive, monarki e kufizuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë tiparet e qytetërimit bizantin, shkaqet e lindjes, organizimin shoqëror, politik e ekonomik.</li> <li>- Të përcaktojë shkaqet e ndarjes së kishës kristiane.</li> <li>- Të përcaktojë rëndësinë e kodit të Justinianit në qytetërimin botëror.</li> <li>- Të përshkruajë tiparet e qytetërimit arab dhe ndikimin e tij në Evropë.</li> <li>- Të shpjegojë tiparet e feudalizmit.</li> <li>- Të përshkruajë shoqërinë mesjetare dhe shtresëzimet e saj (hierarkia feudale, fshatari i lirë, bujkrobi, shoqëria qytetare).</li> <li>- Të vlerësojë rolin e qyteteve mesjetare në zhvillimin ekonomik, shoqëror, politik dhe kulturor të shoqërisë mesjetare.</li> <li>- Të gjykojë mbi kryqëzatat dhe pasojat e tyre.</li> <li>- Të krahasojë veçoritë e monarkisë angleze me atë franceze.</li> </ul>
--	--	--

## QYTETËRIMET MODERNE DHE BASHKËKOHORE

### **Linja 4**

### **Qytetërimet në fillimet e historisë moderne**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Rilindja, “Bota e re”, reformacion, kundër reformacion, protestantizëm, kalvinizëm, ndarje fetare, ndryshimet sociale dhe shoqërore në shek. XVI-XVII.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
4.	<b>Qytetërimet në fillimet e historisë moderne</b>	<p><b>Ndryshimet në qytetërimet botërore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rilindja, fryma e saj në art, kulturë, shkencë e në shoqëri.</li> <li>- Evropa drejt njoftes së “Botës së re”: Rrethanat e favorshme tekniko-shkencore dhe ekonomiko-politike nxisin zbulimet gjografike.</li> <li>- Në kërkim të rrugëve të reja: zbulimet e mëdha gjografike.</li> <li>- Ndryshimet fetare në Evropë.</li> <li>- Rrënjet e Reformacionit, doktrina protestante, përfaqësuesit kryesorë.</li> <li>- Kundërreforma katolike dhe karakteri relativ i saj.</li> <li>- Shoqëria, mënyra e jetesës në shek. XVI-XVII.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë ndryshimet e rëndësishme social- kulturore që ndodhën gjatë Rilindjes, duke përfshirë dhe ndikimin e saj në Evropë .</li> <li>- Të përcaktojë në hartë rrugën që pëershkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të “Botës së Re”;</li> <li>- Të analizojë faktorët historikë që nxitën zbulimet e mëdha gjografike.</li> <li>- Të gjykojë rrjedhojat e zbulimeve të mëdha gjografike.</li> <li>- Të argumentojë lëvizjen protestante.</li> <li>- Të përcaktojë rolin e Luterit, Zvinglit e Kalvinit në lëvizjen protestante.</li> <li>- Të vlerësojë rolin e protestantizmit në ndryshimet në Evropë.</li> <li>- Të listojë vendimet e Koncilit të Trentos.</li> </ul>

			<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përcaktojë ndryshimet sociale – shoqërore që ndodhën gjatë shek. XVI – XVII.</li> </ul>
--	--	--	---

## Linja 5

## Koha e ndryshimeve thelbësore

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: absolutizëm, kolonializëm, iluminizëm, revolucion, revolucion politik, revolucioni i lavdishëm, revolucion industrial, revolucion social, luftë civile, protektorat, restaurim, kompromis, kushtetutë, Deklaratë e të Drejtave të Njeriut, liri, barazi, vëllazëri, liberalizëm, konservatorizëm, legjitimitet.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
5.	<b>Koha e ndryshimeve thelbësore</b>	<p><b>Ndryshimet në kulturën politike dhe në ekonominë evropiane</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kultura politike dhe shtetet moderne: Absolutizmi në Francë, Iluminizmi.</li> </ul> <p><b>Revolucionet dhe ideologjitet e reja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Revolucionet në Angli, Amerikë e Francë)</li> <li>- Revolucioni anglez: shkaqet e fillimit, etapat, Revolucioni i Lavdishëm, triumfi i parlamentarizmit.</li> <li>- Revolucioni amerikan: pavarsia e kolonive angleze në Amerikën e Veriut, konflikti i 13 kolonive angleze me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të listojë tiparet e absolutizmit në Francë.</li> <li>- Të argumentojë faktorët që nxitën revolucionin francez.</li> <li>- Të rendisë reformat e ndërmarrana nga N. Bonoparti.</li> <li>- Të analizojë ndikimet e reformave të N. Bonapartit në qytetërimin evropian.</li> <li>- Të listojë idetë themelore iluministe që lanë gjurmë në historinë evropiane.</li> <li>- Të analizojë vlerat e Aktit të të Drejtave të Njeriu (Bill of Rights), të miratuara nga parlamenti anglez.</li> <li>- Të vlerësojë kushtetutën amerikane dhe risitë që solli në qytetërimin botëror.</li> </ul>

		<p>Anglinë, shpallja e kushtetutës amerikane, lufta civile.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Revolucioni francez, fazat e tij, Deklarata mbi të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit.</li> <li>- Periudha Napoloniane e Francës, Europa pas rënies së tij (Kongresi i Vjenës).</li> <li>- Revolucioni i Parë dhe i Dytë Industrial</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë shkaqet dhe rrjedhojat e Luftës Civile në ShBA.</li> <li>- Të analizojë vendimet e Kongresit të Vjenës.</li> <li>- Të evidentojë ndryshimet politike që pësoi Evropa pas vendimeve të Kongresit të Vjenës.</li> <li>- Të krahasojë shkaqet dhe rrjedhojat e Revolucionit të Parë Industrial kundrejt Revolucionit të Dytë Industrial, duke evidentuar ndikimet që ato patën në jetën ekonomike e sociale të qytetërimeve botërore.</li> </ul>
--	--	--	---

### Linja 6

### Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: demokraci, marksizëm, leninizëm, komunizëm, diktaturë e proletariatit, ekonomi socialiste, fashizëm, antisemitizëm, nazizëm, imperializëm, social-demokraci, racizëm, ekonomi, krizë ekonomike globale, kurs i ri.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
6.	<b>Periudha e tronditjeve të mëdha 1914-1945</b>	<p><b>Fillimet e krizave të shek. XX-të. Lufta dhe paqja (1914-1920)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkaqet dhe preteksti për fillimin luftës. Fillimi i Luftës së Parë Botërore. Përfundimi i luftës, Konferenca e Paqes,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore.</li> <li>- Të gjykojë pasojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve të paqes në përfundim të saj.</li> <li>- Të përshkruajë karakterin dhe vlerat e planit amerikan për paqen</li> </ul>

		<p>karakteri dhe vendimet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 14 pikat e Willsonit.</li> </ul> <p><b>Qytetërimet midis dy luftërave botërore.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diktaturat e majta dhe të djathta.</li> <li>- BRSS nën Stalinin.</li> <li>- Fashizmi në Itali.</li> <li>- Ardhja në pushtet e nazistëve në Gjermani.</li> <li>- Kriza e madhe ekonomike, tiparet dhe rrjedhojat e saj.</li> </ul> <p><b>Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkaqet e fillimit të Luftës së Dytë Botërore.</li> <li>- Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore.</li> </ul>	<p>në botë (14 pikat e Willsonit).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjykojë mbi vendimet e Konferencës së Paqes në Paris.</li> <li>- Të analizojë tiparet e diktaturës së proletariatit të vendosur në Rusi (1917-1924).</li> <li>- Të analizojë tiparet e diktaturave të djathta (fashizmit dhe nazizmit).</li> <li>- Të krasojojë tiparet e sistemeve totalitare të majta dhe të djathta, duke bërë dallimet midis tyre.</li> <li>- Të analizojë shkaqet dhe tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- stoqet në tregje,</li> <li>- falimentimin e bankave,</li> <li>- papunësinë.</li> </ul> </li> <li>- Të analizojë pasojat e krizës ekonomike në periudhën midis dy luftërave.</li> <li>- Të shpjegojë politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike: <ul style="list-style-type: none"> <li>➢ Shteti i mirëqenies në Angli,</li> <li>➢ Fronti Popullor në Francë,</li> <li>➢ Marrëveshja e re (Kursi i ri i Ruzveltit) në SHBA.</li> </ul> </li> <li>- Të përshkruajë masat e marra nga Ruzvelli për nxjerrjen e ShBA-së nga kriza.</li> <li>- Të përcaktojë shkaqet e fillimit të</li> </ul>
--	--	--	---

			<p>Luftës së Dytë Botërore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë trashëgiminë e Luftës së Dytë Botërore:           <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ pasojat ekonomike,</li> <li>➤ pasojat sociale,</li> <li>➤ pasojat psikologjike;</li> </ul> </li> </ul>
--	--	--	---

### Linja 7

### Qytetërimet bashkëkohore (1945 deri më sot)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Luftë e Ftohtë, perde e hekurt, tensioni Veri-Jug, superfuqi, bllok, denazistifikim, çmilitarizim, kursi i brezit të ri, neokonservatorizëm, globalizëm, “gllasnost”, “perestrojkë”, integrim, integrim euro-atlantik, euroskepticizëm, integrim rajonal, grup etnik, konflikt etnik, demokratizim, zgjedhje të lira, sistem shumëpartiak etj.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
7.	<b>Qytetërimet bashkëkohore</b>	<p><b>Qytetërimi botëror në periudhën 1945-1990</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konferenca e Paqes.</li> <li>- Krijimi i OKB-së, arsyet dhe qëllimi i saj.</li> <li>- Fillimi i Luftës së Ftohtë.</li> <li>- Krijimi i dy superfuqive (ShBA dhe BRSS).</li> <li>- Veçoritë e ekonomisë në BRSS gjatë periudhës së Gorbaçovit.</li> <li>- Veçoritë e ekonomisë në ShBA-së gjatë periudhës së Kenedit dhe Reganit.</li> <li>- Përfundimi i Luftës së Ftohtë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të listojë vendimet e Konferencës së Paqes pas Luftës së Dytë Botërore.</li> <li>- Të analizojë kushtet historike të krijimit, karakterin dhe qëllimet e OKB-së.</li> <li>- Të analizojë konfrontimin midis dy bloqeve në kuadër të Luftës së Ftohtë.</li> <li>- Të gjykojë mbi reformat e ndërmarra nga Kenedi dhe Regani në ShBA.</li> <li>- Të gjykojë mbi reformat e Gorbaçovit dhe pasojat e tyre.</li> <li>- Të analizojë karakteristikat e ekonomisë pas luftës.</li> </ul>

		<p><b>Fitorja e demokracisë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkimi Evropian: hapat e mëtejshëm drejt integrimit evropian.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të evidentojë arsyet e bumin ekonomike në shtetet e bllokut perëndimor, duke e krahasuar me zhvillimin ekonomik në bllokun komunist.</li> <li>- Të argumentojë shkaqet e revolucioneve demokratike në Evropën Lindore.</li> <li>- Të përshkruajë ngjarjet që shënuan përfundimin e Luftës së Ftohtë.</li> <li>- Të analizojë shkaqet e dështimit të sistemeve komuniste në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore;</li> <li>- të evidentojë në hartën politike të Evropës, ndryshimet territoriale të pas Luftës së Ftohtë.</li> <li>- Të analizojë shkaqet dhe rrjedhimet e ndryshimeve territoriale në Evropë: Bashkimi i Gjermanisë, shpërbërja e BS-së dhe e Jugosllavisë.</li> <li>- Të analizojë rolin e organeve të BE-së dhe parimet themelore të saj.</li> </ul>
--	--	---	--

## HISTORIA E SHQIPTARËVE

**Linja 8**

**Parahistoria 100000 vjet - 3500 vjet më parë**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Arkeologjia dhe parahistoria shqiptare; popullsia paleolitike në trojet shqiptare; qytetërimi neolit; Nga epoka e gurit te metalet.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
8.	<b>Parahistoria 100000 vjet – 3500 vjet më parë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arkeologjia dhe parahistoria shqiptare.</li> <li>- Popullsia paleolitike në trojet shqiptare.</li> <li>- Qytetërimi neolit.</li> <li>- Nga epoka e gurit te metalet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: parahistori, historia, para ilirë, protoilirë, paleolit, neolit, eneoilit, periudha e hekurit, pellazg, palafit, tuma.</li> <li>- Të vlerësojë dukuritë e zhvillimit dhe të evolucionit të qytetërimit nga neoliti deri te metalet.</li> </ul>

### Linja 9

### Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II – mijëvjeçari I para erës së re)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Etnogjeneza dhe trojet ilire në Ballkan, jeta ekonomike e shoqërore e ilirëve, kolonitë helene dhe ilirët, Shteti i Epirit, Mbretëria Dardane, Roma dhe Iliria.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
9.	<b>Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II – mijëvjeçari I para erës së re)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Etnogjeneza dhe trojet ilire në Ballkan.</li> <li>- Jeta ekonomike dhe shoqërore e ilirëve.</li> <li>- Kolonitë helene dhe ilirët.</li> <li>- Shteti i Epirit.</li> <li>- Mbretëria Dardane.</li> <li>- Roma dhe Iliria.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: etnogjenezë, koloni helene, provinca, Lidhja Epirote.</li> <li>- Të listojë qytetërimet ilire më të zhvilluara.</li> <li>- Të listojë burimet kryesore mbi etnogjenezën ilire.</li> <li>- Të përcaktojë hapësirën e fiseve ilire.</li> <li>- Të përcaktojë kohën, hapësirën e shtrirjes, tiparet e zhvillimit dhe kushtet historike të formimit të shteteve ilire.</li> <li>- Të përshkruajë shkaqet e</li> </ul>

			luftërave ilire-romake dhe ndikimin e tyre në Iliri.
--	--	--	--

## Linja 10

## Shqipëria mesjetare (Shek V – XIV)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këto terma dhe koncepte kyçë: Mesjeta e hershme arbërore (shek. V-X); Arbëria (Shqipëria mesjetare) mes Lindjes dhe Perëndimit (jeta politike në shek. XI-XIV); prona feudale dhe jeta qytetare në Arbëri (Shqipëria mesjetare); organizimi politik në mesjetën e vonë (shek. XIV-XV); përhapja e krishterimit dhe e organizimit kishtar; arsimi, arti dhe kultura në Arbëri (Shqipëria mesjetare); Iliria, Arbëria, Shqipëria - vazhdimësi etnokulturore.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
10.	<b>Shqipëria mesjetare (shek V–XIV)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pasojat e përfshirjes së Ilirisë nën Bizant dhe ndikimet e dyndjeve sllave në Ilirinë e veriut.</li> <li>- Principatat e shekujve XII-XIII.</li> <li>- Marrëdhëniet feudale dhe pronësia tokësore në Arbëri (Shqipëria mesjetare).</li> <li>- Jeta qytetare në Arbëri (Shqipëria mesjetare).</li> <li>- Principatat e shekujve XIV-XV.</li> <li>- Përhapja e krishterimit dhe e organizimit kishtar.</li> <li>- Arsimi, dhe kultura në Arbëri (Shqipëria mesjetare).</li> <li>- Iliria, Arbëria, Shqipëria –</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: Bizant, metropol i Ilirikut, asimilim, qytete komuna, principata, korporata, Mbretëria e Arbit.</li> <li>- Të përshkruajë kohën dhe pasojat e dyndjeve dhe të pushtimeve të huaja në Arbërinë mesjetare.</li> <li>- Të identifikojë kohën e principatave dhe të përcaktojë elementet shtetërore dhe rëndësinë e tyre.</li> <li>- Të përshkruajë marrëdhëniet feudale në Arbëri.</li> <li>- Të përshkruajë gjendjen fetare në Arbërinë mesjetare.</li> <li>- Të shpjegojë dhe të ilustrojë tiparet dhe karakterin e arsimit dhe të kulturës mesjetare në Arbëri.</li> <li>- Të argumentojë lidhjet e</li> </ul>

		vazhdimësi etnokulturore.	vazhdimesisë midis pellazgëve, ilirëve dhe arbërve.
--	--	---------------------------	---

### Linja 11

### Shqiptarët gjatë sundimit osman (shek. XV – XX)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këtë terma dhe koncepte kyçë: besëlidhja shqiptare, formimi i shtetit dhe institucionet e tij; veprimet luftarake, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rëndësia e epokës së Skënderbeut;jeta ekonomike, sociale e kulturore gjatë sundimit osman në Shqipëri; rezistenca e shqiptarëve, pashallëqet shqiptare; Rilindja Kombëtare: lufta për tërësinë tokësore dhe autonominë shqiptare; përpjekjet për gjuhë, arsim e kulturë gjatë Rilindjes Kombëtare.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
11.	<b>Shqiptarët gjatë sundimit osman (shek. XV-XX)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Besëlidhja shqiptare dhe shteti i Skënderbeut.</li> <li>- Politika e jashtme e Skënderbeut dhe rëndësia e epokës së Skënderbeut.</li> <li>- Jeta ekonomike, sociale e kulturore gjatë sundimit osman në Shqipëri.</li> <li>- Pashallëqet shqiptare.</li> <li>- Rilindja Kombëtare.</li> <li>- Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit për autonomi dhe tërësi territoriale.</li> <li>- Përpjekje për gjuhë, arsim e kulturë gjatë Rilindjes Kombëtare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë shkaqet e formimit dhe elementet e shtetit të Skënderbeut.</li> <li>- Të tregojë disa reforma të pashallarëve shqiptarë për forcimin e pashallëkut si shtet autonom.</li> <li>- Të përshkruajë programin e Rilindjes Kombëtare.</li> <li>- Të përshkruajë tiparet e jetës arsimore, kulturore të shqiptarëve gjatë sundimit osman.</li> <li>- Të analizojë veprimet e Lidhjes së Prizrenit për tërësi territoriale dhe autonomi.</li> <li>- Të listojë vendimet e Kongresit të Manastirit dhe Kongresit të Elbasanit duke evidentuar rëndësinë e tyre.</li> </ul>

**Linja 12****Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Pavarësia e Shqipërisë, luftërat ballkanike dhe qëndrimi i Fuqive të Mëdha; Principata e Vudit, Kryengritja e Shqipërisë se Mesme dhe lëvizja "Vorio-epirote"; shqiptarët në Luftën e Parë Botërore, veçoritë e pushtimit dhe lëvizja kombëtare; Kongresi i Durrësit dhe Kongresi i Lushnjës. Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes; zhvillimet politike në vitet 1920-1924. Statusi i Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare; krijimi i Republikës Shqiptare; Mbretëria Shqiptare, organizimi i saj juridik, social dhe ekonomik; marrëdhëniet ndërkombëtare të mbretërisë.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
12.	<b>Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veprimtaria e Qeverisë së Vlorës 1912-1914.</li> <li>- Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për Shqipërinë.</li> <li>- Shqipëria nën regjimin e princ Vudit.</li> <li>- Traktati i Fshehtë i Londrës në vitin 1915 dhe Kongresi i Durrësit.</li> <li>- Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris (pas Luftës së Parë Botërore).</li> <li>- Kongresi i Lushnjës dhe qeveria e Sulejman Delvinës.</li> <li>- Republika shqiptare në vitet 1925-1928.</li> <li>- Monarkia shqiptare në vitet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: shtet sovran, Komision Ndërkombëtar i Kontrollit, statut, statut organik, Këshill i Lartë, Këshill Kombëtar.</li> <li>- Të listojë datat e rëndësishme të historisë kombëtare 1912-1939.</li> <li>- Të përshkruajë rrugën e krijimit dhe zhvillimit të shtetit shqiptar nga viti 1912-1939.</li> <li>- Të përshkruajë format e qeverisjes dhe dallimet në organizimin e shtetit shqiptar nga viti 1912-1939.</li> <li>- Të analizojë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë gjatë qeverisjes së I. Qemalit, princ Vudit, F. Nolit, A. Zogut.</li> <li>- Të shpjegojë përbajtjen e statuteve apo kushtetutave të viteve 1920-1928.</li> </ul>

		1928-1939.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë dhe të krahasojë disa nga reformat më të rëndësishme ekonomike, politike dhe shoqërore të ndërmarra gjatë viteve 1913;1914;1925-1939.</li> <li>- Të shpjegojë përbajtjen e Traktatit të Fshehtë të Londrës, Konferencës së Paqes së Parisit, Kongresit të Durrësit, Kongresit të Lushnjës.</li> </ul>
--	--	------------	---

### Linja 13

### Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939-1944)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këtë terma dhe koncepte kyçë: Pushtimi italian dhe fillimet e rezistencës shqiptare në vitet 1939-1941; rezistenca ndaj pushtuesit italian në vitet 1942-1943; përpjekjet e shqiptarëve për bashkim; pushtimi gjerman dhe rezistenca ndaj tij në periudhën shtator 1943 - maj 1944; lufta për çlirimin e plotë të vendit në periudhën maj - nëntor 1944 dhe rezultatet e saj; Kosova e Çamëria gjatë Luftës II Botërore.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
13.	<b>Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939-1944)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sulmi fashist italian i 7 prillit, administrata shtetërore dhe rezistenca gjatë pushtimit italian në vitet 1939-1943.</li> <li>- Platforma politike e PKSh-së, Ballit Kombëtar, Legalitetit, Konferencës së Pezës dhe Konferencës së Mukjes gjatë Luftës Antifashiste.</li> <li>- Kongresi i Përmetit dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: ultimatum, agresion fashist, Front Antifashist, këshill, çetë, PKSh, Lëvizja e Legalitetit, Dekalog, Asamble Kushtetuese, pavarësi relative, Këshill i Përgjithshëm, Komitet Antifashist.</li> <li>- Të identifikojë datat, duke i lidhur me ngjarjet përkatëse, si: 7 prill 1939; 12 prill 1939; 16 shtator 1942; 16 tetor 1943; 3 gusht 1943; 24-28 maj 1944; 17 nëntor 1944;</li> </ul>

		<p>çlirimi i plotë i Shqipërisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kosova gjatë Luftës II Botërore.</li> <li>- Çamëria gjatë Luftës II Botërore.</li> </ul>	<p>29 nëntor 1944.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë rrethanat e pushtimit nazifashist dhe qëndrimin e shqiptarëve ndaj tij.</li> <li>- Të analizojë vendimet e konferencave gjatë Luftës dhe programet e forcave politike të Luftës.</li> <li>- Të argumentojë karakterin dhe rëndësinë e Luftës ANC për shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve politikë të Shqipërisë.</li> </ul>
--	--	--	---

#### Linja 14

#### Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Vendosja e regjimit komunist; politika e brendshme e tij në vitet 1945-1990; krijimi i ekonomisë së centralizuar shtetërore; politika e Jashtme e Shqipërisë në vitet 1945-1990; arsimi, shkenca, kultura, arti e sporti në vitet 1945-1990; qëndresa antikomuniste dhe emigracioni politik pas Luftës II Botërore; Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavinë.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
14.	<b>Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosja e regjimit dhe e institucioneve komuniste.</li> <li>- Reformat e para të tranzisionit komunist dhe forcimi i tipareve diktatoriale të shtetit komunist.</li> <li>- Krijimi i ekonomisë së centralizuar shtetërore.</li> <li>- Politika e Jashtme e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë disa reforma ekonomike gjatë regjimit komunist.</li> <li>- Të analizojë orientimin dhe politikat e Jashtme të shtetit shqiptar në periudha të ndryshme të historisë nga viti 1944 deri në vitin 1990.</li> <li>- Të analizojë dhe të argumentoje rolin e zhvillimeve politike,</li> </ul>

		<p>Shqipërisë në vitet 1945-1990.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Arsimi, shkenca, kultura, arti e sporti në vitet 1945-1990.</li> <li>- Qëndresa antikomuniste brenda dhe jashtë Partisë së Punës.</li> <li>- Kosova dhe shqiptarët në Republikën e Jugosllavisë.</li> </ul>	<p>ekonomike, kulturore, ideologjike ndërkombëtare në zhvillimet e brendshme në Shqipëri.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë liritë dhe të drejtat e njeriut sipas kushtetutave komuniste.</li> <li>- Të përshkruajë format dhe rezultatet e qëndresës antikomuniste.</li> <li>- Të analizojë dhe të argumentojoë platformat shtetërore diskriminuese në Jugosllavi.</li> </ul>
--	--	--	--

### Linja 15

### Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990 – 2008

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Përbysja e diktaturës komuniste dhe hedhja e hapave të parë të demokracisë; vendosja e shtetit të së drejtës dhe e ekonomisë së tregut; politika e jashtme e shtetit demokratik shqiptar dhe orientimi integrues në Europë në vitet 1990-2008; krizat në demokracinë e re shqiptare dhe kapërcimi i tyre; Kosova në vitet 1990-2008.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
15.	<b>Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2008</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëvizja e dhjetorit të vitit 1990 dhe shpallja e pluralizmit politik.</li> <li>- Vendosja e demokracisë.</li> <li>- Vendosja e shtetit të së drejtës dhe e ekonomisë së tregut.</li> <li>- Integrimi Evropian i Shqipërisë.</li> <li>- Pranimi në NATO dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të analizojë rolin dhe kërkosat studentore në shpalljen e pluralizmit.</li> <li>- Të evidentojë problemet dhe sfidat e demokracisë në Shqipëri.</li> <li>- Të listojë hapat drejt integrimit evropian të Shqipërisë dhe rëndësinë e tyre.</li> <li>- Të shpjegojë ngjarjet që çuan drejt stabilizimit të jetës politike në</li> </ul>

		<p>nënshkrimi i MSA-së.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Liberalizimi i vizave.</li> <li>- Kosova në vitet 1990-2008.</li> </ul>	<p>vend.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të rendisë faktorët që çuan në pavarësinë e Kosovës.</li> <li>- Të vlerësojë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën.</li> </ul>
--	--	--	--

## **LINJAT E PROGRAMIT – HISTORI E THELLUAR**

### **Fusha 1**

### **Qytetërimet në Antikitet dhe në Mesjetë**

Qytetërimi antik aziatik (Kina, India, Japonia)

Qytetërimi mesjetar – urë lidhëse në mes qytetërimit antik dhe atij modern (shek. VI – XVI )

### **Fusha 2**

### **Qytetërimet moderne dhe bashkëkohore**

Jeta në qytetet evropiane para dhe gjatë periudhës së industrializimit (shek. XV-XX)

Qytetërimet aziatike në kohët moderne (shek. XV-XIX)

Qytetërimet bashkëkohore (gjysma e dytë e shek. XX)

### **Fusha 3**

### **Historia e shqiptarëve**

Historia dhe historiani

Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)

Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II – I p.e.s.)

Shqipëria mesjetare (shek. V – XIV)

Shqipëria gjatë sundimit osman (shek. XV-XX)

Shteti i pavarur shqiptar, 1912-1939

Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore

Shqipëria gjatë regjimit komunist

Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990-2008.

## **PËRSHKRIMI I LINJAVE DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT**

## QYTETËRIMET NË ANTIKITET DHE NË MESJETË

### **Linja 1.**

### **Qytetërimi antik aziatik (Kina, India, Japonia)**

Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë një pamje të saktë dhe të plotë për qytetërimin në Azinë e mesme dhe të largët (Indi, Kinë, Japoni). Linja synon të formojë koncepte të qarta shkencore mbi qytetërimin antik në këto rajone: shtrirjen e tyre, rrugën e formimit të shtetit dhe veçoritë e jetës shoqërore, duke theksuar kontributin e këtyre qytetërimeve në qytetërimin botëror.

<b>Nr</b>	<b>Linja</b>	<b>Përshkrimi i përbajtjes</b>	<b>Objektivat</b>
<b>1.</b>	<b>Qytetërimi antik aziatik (Kina, India, Japonia)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qytetërimi antik aziatik dhe tiparet e tij.</li> <li>- Shteti në qytetërimet antike aziatike.</li> <li>- Filozofia dhe ligji (rrugullat) në qytetërimet antike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përdorë saktë këta terma e koncepte kyçe historike: kastë, shoqëri e myllur, dinasti, mbretëri, brahmanizëm, budizëm, konfucianizëm, kristianizëm, sekt fetar.</li> <li>- Të përcaktojë në hartë shtrirjen e qytetërimeve antike aziatike (Indi, Kinë, Japoni).</li> <li>- Të argumentojë rolin e mjedisit në zhvillimin e qytetërimeve antike aziatike.</li> <li>- Të përshkruajë rrugën e formimit të shtetit në Indi, Kinë e Japoni.</li> <li>- Të listojë parimet kryesore të filozofisë së Brahmës, Budës e Konfucit.</li> <li>- Të dallojë të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet sistemet ligjore në Perandoritë aziatike (Indi, Kinë, Japoni).</li> </ul>

**Linja 2.**

**Qytetërimi mesjetar – urë lidhëse mes qytetërimit  
antik dhe atij modern ( shek. VI – XVI )**

Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë dhe të qartësojë veçorinë e qytetërimit mesjetar, natyrën e tij të dyfishtë, si një periudhë e cila ndërpret shkëlqimin e qytetërimit antik dhe i pararend qytetërimit të ri modern. Linja argumenton rolin e fesë në Mesjetë dhe zbehjen graduale të saj në raport me zhvillimin e shkencës artit dhe kulturës.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
2.	<b>Qytetërimi mesjetar – urë lidhëse midis qytetërimit antik dhe atij modern (shek. VI – XVI)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mesjeta në vendet aziatike: Kinë, Indi, Japoni (shek. VI-XIV).</li> <li>- Qytetërimi bizantin (shek. VI-XV).</li> <li>- Besimi, arsimi, shkenca dhe arti gjatë qytetërimit mesjetar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë tiparet kryesore të qytetërimit mesjetar në Kinë, Indi dhe Japoni.</li> <li>- Të zbulojë tiparet e epokës së Justinianit dhe vlerat e saj.</li> <li>- Të argumentojë thelbin e ikonoklazmës dhe lidhjet e saj me politikën.</li> <li>- Të argumentojë vlerat e pellgut të Mesdheut, si kryqëzim i qytetërimeve: bizantine, arabe dhe evropiane.</li> <li>- Të vlerësojë skizmat që lindën dhe lidhjet e tyre me jetën politike.</li> <li>- Të argumentojë kthesën që mori arsimi dhe shkenca në Mesjetë dhe pasojat që sollën ato.</li> </ul>

**QYTETËRIMET MODERNE DHE BASHKËKOHORE**

**Linja 3**

**Jeta në qytetet evropiane para dhe gjatë periudhës së industrializimit (shek. XV-XX)**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: revolucionet në fushën e teknologjisë, tregtisë, komunikacionit, shndërrimet industriale e sociale, urbanizëm, shtresëzim i shoqërisë, organizim i punës, zhvillim rural, ide marksiste, parime të demokracisë liberale, sindikatë, shtresëzimi social i popullsisë, qëndrimi i ideologjisë marksiste ndaj punonjësve, roli i punonjësve në demokracinë liberale.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
3.	<b>Jeta në qytetet evropiane para dhe gjatë periudhës së industrializimit (shek. XV-XX)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Jeta qytetare në Evropë në periudhën para industriale dhe industriale. (shek. XV-XX)</li> <li>- Epoka e mekanizimit dhe lindja e ideve të reja politike (shek. XIX-XX)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të argumentojë ndikimin e industrializimit në urbanizmin e qyteteve evropiane.</li> <li>- Të listojë tiparet e qyteteve industriale.</li> <li>- Të gjykojë mbi ndryshimet në organizmin e punës në zonat rurale edhe ato urbane.</li> <li>- Të analizojë kuptimin e mobilizimit social dhe politik të punonjësve.</li> <li>- Të analizojë idetë themelore të marksizmit.</li> <li>- Të përcaktojë tiparet e sistemit politik të demokracisë liberale.</li> <li>- Të argumentojë rolin e sindikatave të punëtorëve.</li> <li>- Të gjykojë mbi qëndrimin e socialdemokratëve për shtetin, pronën dhe shoqërinë.</li> <li>- Të analizojë dallimet midis socialdemokracisë dhe marksizmit.</li> </ul>

**Linja 4**

**Qytetërimet aziatike në kohët moderne (shek. XV-XIX)**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: ekspansioni evropian, rrugët tregtare, kolonializmi imperialist, krijimi i kolonive, administrimi kolonial, shtojca ekonomie; kultura tradicionale, shogunati, reforma Mejxi në Japoni; kultura kinezë, modernizmi, fazat e izolimit, vetizolimi kinez, reformacioni kinez; nocioni “Lindje e Mesme”, nacionalizmi indian, shndërrime të kryqëzuara.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
4.	<b>Qytetërimet aziatike në kohët moderne (shek. XV-XIX)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lindja dhe përhapja e kolonializmit (shek. XV-XVIII)</li> <li>- Lindja e Mesme dhe e Largët gjatë kohës së ekspansionit evropian në Azi (shek. XV – XVII)</li> <li>- Tradita në Lindjen e Mesme dhe të Largët dhe transformimi i saj (shek. XVII-XIX)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë fazat dhe motivet e kolonializmit.</li> <li>- Të tregojë kuptimin e “shtojcave ekonomike”.</li> <li>- Të listojë faktorët që çuan në dobësimin e Perandorisë Indiane.</li> <li>- Të gjykojë mbi zhvillimet ekonomike dhe kulturore në qytetërimin kinez.</li> <li>- Të analizojë pengesat e Kinës drejt modernizmit (shek. XV-XIX)</li> <li>- Të përshkruajë veçoritë e zhvillimit të Japonisë (shek XV-XIX)</li> <li>- Të përshkruajë fazat e izolimit të Japonisë gjatë shek. XVI-XVII.</li> <li>- Të analizojë tiparet e kolonializmit imperialist.</li> <li>- Të shpjegojë përbajtjen e nocionit “Lindje e Mesme”.</li> <li>- Të përshkruajë tiparet e qeverisjes në Lindjen e Mesme shek. XV-XVI.</li> <li>- Të gjykojë mbi marrëdhëniet e evropianëve në Lindjen e Mesme.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të argumentojë veçoritë e administrimit kolonial të Indisë (shek. XIX).</li> <li>- Të shpjegojë përmbajtjen e “shndërrimeve të kryqëzuara”.</li> <li>- Të analizojë lindjen e nacionalizmit dhe rolin e Kongresit Kombëtar në Indi.</li> <li>- Të listojë ngjarjet që çuan në fundin e vetizolimit të Kinës në shek. XIX.</li> <li>- Të analizojë shkaqet e përfshirjes së dinastisë Çin në Kinë.</li> <li>- Të rendisë kërkесat e reformatorëve në Kinën e shek. XIX.</li> <li>- Të argumentojë tiparet e traditës japoneze.</li> <li>- Të gjykojë mbi reformat Mejxi në Japoni.</li> </ul>
--	--	---

### **Linja 5**

### **Qytetërimet bashkëkohore (gjysma e dytë e shek. XX)**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këto terma dhe koncepte kyçe: Sistemi politik i demokracisë liberale pas Luftës së Dytë Botërore, demokratizimi i vendeve nazifashiste, institucionë demokratike, çështjet sociale, shtetëzim në demokraci, shteti i mirëqenies sociale, vala e tretë drejt demokratizimit, tranzicioni demokratik në Spanjë, diktatura komuniste në Kinë (Mao Ce Duni), Revolucioni i Madh Kulturor dhe Proletar, reformat shumëplanëshe të Ten Hsiao Pinit; demokratizmi i Japonisë, karakteri i kushtetutës, faktorët nxitës të zhvillimit të shpejtë të ekonomisë japoneze. Gandizmi, demokratizmi i Indisë, dekolonizimi i Afrikës; shpërbërja e Jugosllavisë dhe konflikti ndëretnik; globalizmi.

Nr	Linja	Përshkrimi i përmbajtjes	Objektiva

<b>5.</b>	<b>Qytetërime bashkëkohore (gjysma e dytë e shek. XX)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Konsolidimi i demokracisë liberale në shtetet e Evropës Perëndimore (1945-1990)</li> <li>- Ndryshimet në qytetërimet në Kinë dhe Japoni mbas Luftës së Dytë Botërore (1945-1990)</li> <li>- Lëvizjet nacionaliste në vendet koloniale.</li> <li>- Përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe sfidat e reja të qytetërimeve botërore.</li> <li>- Globalizmi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë tiparet e sistemit politik të demokracisë liberale.</li> <li>- Të gjykojë mbi faktorët e demokratizmit të Italisë dhe Gjermanisë Perëndimore.</li> <li>- Të evidentojë dallimet në qëndrimin e partive për çështjet ekonomike dhe sociale.</li> <li>- Të listojë arritjet e shtetit të mirëqenies sociale.</li> <li>- Të analizojë problematikat me të cilat u përball shteti i mirëqenies sociale.</li> <li>- Të tregojë veçoritë e Valës së Tretë të Demokratizmit.</li> <li>- Të gjykojë mbi rrugën e tranzicionit të Spanjës.</li> <li>- Të analizojë faktorët që çuan në vendosjen e diktaturës komuniste në Kinë (Lufta Civile)</li> <li>- Të argumentojë tiparet e zhvillimit komunist të Kinës.</li> <li>- Të shpjegojë rrjedhojat e Revolucionit të Madh Kulturor.</li> <li>- Të listojë reformat e Ten Hsiao Pinit në bujqësi, në industri, në ushtri dhe në thithjen e kapitalit të huaj.</li> <li>- Të krasojë ndryshimet mes qeverisjes së Mao Ce Dunit dhe qeverive pasuese.</li> <li>- Të evidentojë përmbytjen e reformave për demokratizmin e Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore.</li> <li>- Të analizojë përmbytjen e kushtetutës</li> </ul>
-----------	---	--	--

		japoneze pas Luftës së Dytë Botërore. <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të gjykojë mbi faktorët që nxitën zhvillimin e shpejtë të Japonisë.</li> <li>- Të argumentojë karakteristikat e zhvillimit ekonomik të Japonisë.</li> <li>- Të përshkruajë rolin e ekonomisë japoneze në atë botërore.</li> <li>- Të analizojë mbi përbajtjen e Gandizmit.</li> <li>- Të përshkruajë tiparet e qeverisjes demokratike në Indi.</li> <li>- Të analizojë sistemet qeverisëse në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut.</li> <li>- Të përshkruajë procesin e dekolonizimit në Afrikë.</li> <li>- Të shpjegojë tiparet e regjimeve politike në Afrikë.</li> <li>- Të evidentojë problemet ekonomike e sociale me të cilat përballet Afrika.</li> <li>- Të argumentojë ndryshimet në hartën gjeografike pas shpërbërjes së BS-së dhe Jugosllavisë.</li> <li>- Të argumentojë ndikimin e globalizmit mbi shtetin kombëtar.</li> </ul>
--	--	---

## HISTORIA E SHQIPTARËVE

### Linja 6

### Historia dhe historiani

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Historia kombëtare dhe vlerat e saj; kriteret metodologjike në shkrimin e historisë së shqiptarëve: burimet, interpretimi, autenticiteti, objektiviteti, shkencat ndihmëse; burimet kryesore të shkruara në

shkrimin e historisë së shqiptarëve (arkivat kryesore dhe puna me to, veprat monumentale të albanologëve të njohur).

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
6.	<b>Historia dhe historiani</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Historia kombëtare dhe vlerat e saj.</li> <li>- Kriteret metodologjike në shkrimin e historisë së shqiptarëve: burimet, interpretimi, autenticiteti, objektiviteti, shkencat ndihmëse etj.</li> <li>- Burimet kryesore të shkruara në shkrimin e historisë së shqiptarëve (arkivat kryesore dhe puna me to, veprat monumentale të albanologëve të njohur).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: histori antike, histori moderne dhe histori bashkëkohore; autenticitet; objektivitet historik; subjektivitet historik; hulumtim.</li> <li>- Të vlerësojë rolin e historisë në njohjen e ngjarjeve të së shkuarës dhe në perspektivat e zhvillimit të tyre në të ardhmen.</li> <li>- Të listojë llojet e burimeve historike, duke bërë dallimin midis tyre sipas rolit dhe rëndësisë së tyre në shkrimin e historisë.</li> <li>- Të listojë shkencat ndihmëse të historisë, duke argumentuar rolin e tyre në pasurimin dhe vërtetësinë e historisë.</li> </ul>

### Linja 7

### Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Historiku i arkeologjisë shqiptare (fillimet, zhvillimi, arritjet); qendrat parahistorike në trevën shqiptare, periudhat: paleolitike e mezolitike (100 000 p.e.s. – 6 000 p.e.s.); neolitike (6000 – 2600 p.e.s.); eneolitike (2600 – 2100 p.e.s.); e bronzit (2100 – 1100) ; e hekurit (1100-); pasqyrimi i botës shpirtërore dhe i artit në parahistori.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat

<p><b>7.</b></p> <p><b>Parahistoria</b>  <b>(100000 vjet – 3500 vjet më parë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Historiku i arkeologjisë shqiptare. (fillimet, zhvillimi, arritjet).</li> <li>- Të njohim qendrat parahistorike në trevën shqiptare, në periudhat nga paleoliti në hekur.</li> <li>- Pasqyrimi i botës shpirtërore dhe i artit në parahistori.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: histori, arkeologji, prehistori, parahistori, paleolit, neolit, eneolit, hekur, qytetërim, kulturë shpirtërore, kulturë materiale.</li> <li>- Të listojë qendrat më të rëndësishme parahistorike në trevat shqiptare në periudhat nga paleoliti në hekur.</li> <li>- Të tregojë disa karakteristika të rëndësishme për secilën nga keto periudha (paleolit-hekur).</li> <li>- Të listojë emrat dhe zbulimet më të rëndësishme të arkeologjisë shqiptare e të huaj në periudha të ndryshme historike.</li> </ul>
---	--	--

### Linja 8

### Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II – I p.e.s.)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Etnogjeneza ilire në veprat e albanologëve; dukuritë dhe tiparet e qytetërimit ilir; Iliria në burimet e shkruara greke; Iliria në burimet e shkruara latine; Epiri sipas Nikëlls Hamendit (1907-2001); ilirët dhe kultura e tyre.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
<b>8.</b>	<b>Qytetërimi ilir mijëvjeçari (II – I p.e.s.)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Etnogjeneza ilire në veprat e albanologëve.</li> <li>- Dukuritë dhe tiparet e qytetërimit ilir.</li> <li>- Iliria në burimet e shkruara greke.</li> <li>- Iliria në burimet e shkruara latine.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë konceptet: etnogjenezë, etnos ilir, Iliri, Epir, epirotë.</li> <li>- Të shpjegojë fakte dhe burime historike mbi origjinën e qytetërimit ilir.</li> <li>- Të gjykojë mbi tiparet e qytetërimit ilir</li> <li>- Të argumentojë rëndësinë e</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ilirët dhe kultura e tyre.</li> <li>- Të gjykojë mbi vlerat e artit dhe trashëgimisë ilire</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>pasqyrimit të zhvillimit të qytetërimit ilir në shkrimet greko-romake.</li> </ul>
--	--	--	--

### Linja 9

### Shqipëria mesjetare (shek. V – XIV)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Shqipëria dhe Bizanti; Gjurmët e dyndjeve në trevat arbërore; Zotërimet veneciane në Shqipëri.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
9.	<b>Shqipëria mesjetare (shek. V–XIV)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arbëria (Shqipëria mesjetare) dhe Bizanti.</li> <li>- Gjurmët e dyndjeve në trevat arbërore (Shqipëria mesjetare).</li> <li>- Zotërimet veneciane në Arbëri (Shqipëria mesjetare).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë faktorët që kushtëzuan përfshirjen e Ilirisë nën Bizant dhe rrjedhimet e kësaj pozite të re për Arbërinë.</li> <li>- Të analizojë shkaqet e rrudhosjes së hartës së Ilirisë dhe të përcaktojë kufijtë e rinj të Arbërisë. Të krahasojë qëndrimin politik të Venedikut të shekullit XIII-XIV me atë të shekullit XIV- XV.</li> <li>- Të shpjegojë shkaqet e ndryshimi të këtij qëndrimi politik.</li> </ul>

### Linja 10

### Shqipëria gjatë sundimit osman (shek. XV-XX)

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Perandoria Osmane dhe Ballkani; figura e Skënderbeut në albanologjinë shqiptare; idetë e rilindësve për çështjen shqiptare; platforma politike gjatë viteve 1878-1915.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
10.	<b>Shqipëria gjatë sundimit osman (shek. XV-XX)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perandoria Osmane dhe Ballkani.</li> <li>- Figura e Skënderbeut në albanologjinë shqiptare.</li> <li>- Idetë e rilindësve për çështjen shqiptare.</li> <li>- Platforma politike gjatë viteve 1878-1912.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë koalicionet ballkanike anti-osmane gjatë shek XIV dhe rezultatet e tyre.</li> <li>- Të përshkruajë rolin e albanologjisë në ndriçimin e figurës së Skënderbeut.</li> <li>- Të listojnë rilindësit shqiptarë duke evidentuar kontributin e tyre në çështjen shqiptare.</li> <li>- Të përshkruajë evoluimin e mendimit politik shqiptar për zgjidhjen e çështjes kombëtare.</li> </ul>

### Linja 11

### Shteti i pavarur shqiptar, 1912-1939

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Përplasjet diplomatike në Konferencën e Ambasadorëve në Londër; tezat e ndryshme rrëth kryengritjes së Shqipërisë së mesme; statuti i zgjeruar i Lushnjës, viti 1922; Monarkia shqiptare dhe përpjekja e saj për evropianizimin e vendit.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
11.	<b>Shteti i pavarur shqiptar 1912-1939</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëndrimi i Fuqive të Mëdha për kufijtë e Shqipërisë 1912-1920.</li> <li>- Tezat e ndryshme rrëth kryengritjes së Shqipërisë së mesme.</li> <li>- Statusi i zgjeruar i Lushnjës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të listojë vendimet e Fuqive të Mëdha për Shqipërinë në vitet 1913; 1920; 1921.</li> <li>- Të evidentojë ndryshimin në trajtimin e Kryengritjes së Shqipërisë së mesme të vitit 1914 ( gjatë qeverisjes së</li> </ul>

		Zogut; gjatë regjimit komunist dhe në ditët e sotme). - Të vlerësojë rëndësinë që pati për shtetin shqiptar statuti i zgjeruar i Lushnjes.
--	--	--

### Linja 12

### Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Përpjekjet për shmangien e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit (dokumente dhe opinione); nacionalizmi shqiptar si forcë e parë e rezistencës; pasojat e Luftës II Botërore në Shqipëri.

Nr	Linja	Përshkrimi i përmbajtjes	Objektivat
12.	<b>Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përpjekjet për shmangien e pushtimit dhe shkaqet e pushtimit (dokumente dhe opinione). Nacionalizmi shqiptar si forcë e parë e rezistencës.</li> <li>- Pasojat e Luftës II Botërore në Shqipëri.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shpjegojë rrugën e agresionit fashist mbi Shqipërinë, duke e ballafauar me qëndrimin e qeverisë zogiste për ta parandaluar këtë pushtim.</li> <li>- Të analizojë qëndrimin e Fuqive të Mëdha në prag të pushtimit fashist të Shqipërisë.</li> <li>- Të vlerësojë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e Luftës Antifashiste dhe karakterin e saj çlirimtar, duke evidentuar elementet e luftës civile.</li> </ul>

### Linja 13

### Shqipëria gjatë regjimit komunist

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Rezistenca në fazat e para të vendosjes së regjimit komunist (revolta e Koplikut, e Postrribës dhe qëndrimi i deputetëve);

kalimi në pronën shoqërore; ndikimi jugosllav; diktatura e proletariatit dhe karakteristikat e saj; lufta e klasave si parim themelor i sistemit socialist, pasojat e saj.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektivat
13.	<b>Shqipëria gjatë regjimit komunist</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rezistenca antikomuniste në vitet 1945-1948.</li> <li>- Kushtetuta e vitit 1946 dhe Kushtetuta e vitit 1976. Parimet themelore, ndryshimet ndërmjet tyre.</li> <li>- Diktatura e proletariatit dhe karakteristikat e saj.</li> <li>- Lufta e klasave si parim themelor i sistemit socialist. Pasojat e saj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë disa forma të rezistencës antikomuniste në Shqipëri.</li> <li>- Të analizojë dhe të krasojë kushtetutën e vitit 1946 me atë të vitit 1976, duke nxjerrë përfundime mbi karakterin progresiv apo regresiv të tyre.</li> <li>- Të argumentojë se liritë dhe të drejtat në kushtetutën e 1946 kishin karakter formal.</li> <li>- Të argumentojë karakterin totalitar të pushtetit komunist.</li> <li>- Të shpjegojë pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut si tipar i vazhdueshëm i regjimit komunist.</li> </ul>

#### **Linja 14**

#### **Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990-2008**

Kjo linjë ka për qëllim të prezantojë këta terma dhe koncepte kyçë: Krijimi i ekonomisë së tregut; masmedia shqiptare në demokraci, ecuria e saj; Shqipëria në rrugën e integrimit euroatlantik 1991-2010.

Nr	Linja	Përshkrimi i përbajtjes	Objektiva
14.	<b>Shndërrimet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i ekonomisë së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajë veçoritë e sistemit të</li> </ul>

	<b>demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990-2008</b>	<p>tregut.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Masmedia shqiptare në demokraci. Ecuria e saj.</li> <li>- Shqipëria në rrugën e integrimit euroatlantik 1991-2010.</li> </ul>	<p>ri politik ekonomik e shoqëror pas viteve 1990.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të vlerësojë masedian shqiptare si kontribuuese e fuqishme në zhvillimin e demokracisë.</li> <li>- Të listojë dhe të analizojë hapat e suksesshëm dhe gradualë në drejtim të integrimit të Shqipërisë në strukturat euroatlantike, duke evidentuar anëtarësimin në NATO dhe liberalizimin e vizave për shqiptarët 1990-2008.</li> </ul>
--	---	---	---

Mësuesit që do të përgatisin nxënësit për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën e historisë së thelluar do të të mbështeten në 154 orët e përcaktuara në këtë program, ku 88 orë i përkasin kurrikulës së historisë bërtHamë dhe 66 orë i përkasin kurrikulës së historisë së thelluar. Kjo ndarje sipas orëve dhe përqindjeve përkatëse paraqitet në tabelat më poshtë.

#### TABELA E PESHAVE SIPAS FUSHAVE

FUSHAT NË PROGRAMIN BËRTHAMË	Ndarja e peshave në orë	Ndarja e peshave në %
Historia e qytetërimeve në antikitet dhe në mesjetë	9	6
Historia e qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore	35	22
Historia e shqiptarëve	44	29
<b>FUSHAT NË PROGRAMIN E THELLUAR</b>		
Historia e qytetërimeve në Antikitet dhe në Mesjetë	7	4
Historia e qytetërimeve moderne dhe bashkëkohore	29	19
Historia e shqiptarëve	30	20
<b>Totali</b>	<b>154</b>	<b>100%</b>

#### TABELA E PESHAVE SIPAS LINJAVE

<b>TABELA E PESHAVE SIPAS LINJAVE NË HISTORINË BËRTHAMË</b>			
Nr.	Linja	Ndarja e	Ndarja e

		peshave në orë	peshave në %
1.	Qytetërimi në parahistori	1	1
2.	Qytetërimi botëror në antikitet (Egjipti, Mesopotamia, Greqia, Roma)	4	3
3.	Qytetërimi botëror në mesjetë(shek. V – XV )	4	3
4.	Qytetërimet në fillimet e historisë moderne	5	3
5.	Koha e ndryshimeve thelbësore	10	6
6.	Periudha e tronditjeve të mëdha (1914-1945)	10	6
7.	Qytetërimet bashkëkohore (1945 deri më sot)	10	6
8.	Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)	3	2
9.	Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II–mijëvjeçari I para erës së re)	5	3
10.	Shqipëria mesjetare. Shek V – XIV	6	4
11.	Shqiptarët gjatë sundimit osman (shek. XV– XX)	7	4
12.	Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1939	7	4
13.	Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore (1939-1944)	6	4
14.	Shqipëria gjatë regjimit komunist (1945-1990)	5	3
15.	Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990- 2008	5	3

#### TABELA E PESHAVE SIPAS LINJAVE NË HISTORINË E THELLUAR

Nr.	Linja	Ndarja e peshave në orë	Ndarja e peshave në %
1.	Qytetërimi antik aziatik (Kina, India, Japonia)	4	3
2.	Qytetërimi mesjetar – urë lidhëse në mes qytetërimit antik dhe atij modern(shek. VI – XVI )	3	2
3.	Jeta në qytetet evropiane para dhe gjatë periudhës së industrializimit (shek. XV-XX)	6	4
4.	Qytetërimet aziatike në kohët moderne (shek. XV-XIX)	11	7
5.	Qytetërimet bashkëkohore (gjysma e dytë e shek. XX.)	12	9
6.	Historia dhe historiani	3	2
7.	Parahistoria (100000 vjet – 3500 vjet më parë)	3	2
8.	Qytetërimi ilir (mijëvjeçari II – I p.e.s.)	5	3
9.	Shqipëria mesjetare (shek. V – XIV)	3	2

<b>10.</b>	Shqipëria gjatë sundimit osman (shek. XV-XX)	4	3
<b>11.</b>	Shteti i pavarur shqiptar, 1912-1939	3	2
<b>12.</b>	Shqipëria gjatë Luftës së Dytë Botërore	2	1
<b>13.</b>	Shqipëria gjatë regjimit komunist	4	3
<b>14.</b>	Shndërrimet demokratike në Shqipëri gjatë viteve 1990-2008	3	2
<b>Totali:</b>		<b>154</b>	<b>100%</b>